

Master Shkencor në Shkenca Politike, *profili* “Politika Evropiane dhe Administrim Publik”

Programi Master i Shkencave Politike në “Studime Evropiane dhe administrim publik” ofron një formim të thelluar teorik në fushën e Studimeve Evropiane dhe e drejton studentin drejt studimeve të doktoratës ose drejt karrierës kërkimore - shkencore. Masteri i Shkencave në Studime Evropiane me fokus në politika evropiane dhe administrim publik bazohet më tepër në një qasje analitike të studimit të dinamikave politike të Bashkimit Evropian. Përveçse të ofrojë një përgatitje të mirë akademike, ky program synon të aftësojë studentët për kryerjen e punëve kërkimore origjinale dhe e vë theksin te metodologjia e kërkimit.

Kurrikula

- o Histori e integritit evropian;
- o Integrimi ekonomik ndërkombëtar;
- o Analiza e politikave publike të BE-së;
- o Politikat e jashtme të Bashkimit Evropian;
- o Modelet e administrimit publik në BE-së.



Kriteret

- o Kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licensuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;
- o Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licensuar dhe akredituar dhe diploma e tyre është njehtësuar nga MASR/QSHA.
- o Kanë përfunduar studime Bachelor në një fakultet me të njëjtin natyrë formimi (emërtimi) si dhe fakulteti i UniBa-së që mbulon programin e kërkuar.

Karriera

Mundësi punësimi në:

- o Institucione Akademike (Universitete);
- o Institucione Kërkimore – Shkencore;
- o Administratën Publike;
- o Organizatat Ndërkombëtare;
- o OJF-të lokale/kombëtare që mbulojnë çështje të integritit evropian.

Kohëzgjatja & Forma e studimit

Studime me kohë të plotë

- Kohëzgjatja normale e studimeve në program
✓ **2 vite akademike.**
- Kohëzgjatja maksimale e studimeve në program
✓ **4 vite akademike.**

Dokumentacioni mbështetës për aplikim:

1. Fotokopje Kartë Identiteti / pasaportë;
2. Fotokopje e diplomës së ciklit të parë e noterizuar / diplomë tjetër studimi e fituar jashtë shtetit dhe e njehsuar nga MASR;
3. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve / suplementi i diplomës;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore + Çertifikatë e notave, e konfirmuar nga DAR/ZA.
5. CV;
6. 2 fotografi;
7. Dëshmi e gjuhës së huaj, të paktën në nivelin B1;
8. Mandatë pagesa për tarifën e aplikimit të kryer në UniBa.



Kontakte të departamentit:

- ☎ +355 69 20 67 247 | +355 69 20 41 222
- ✉ Email: gpc-master.coord@umb.edu.al